



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 5245 Prot.

Tiranë, më 22.08. 2023

Lënda: Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2023-2024.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓
Rruga "Aleksandër Moisiu"
Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit Nr. 14, datë 10.07.2023 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punjonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar" dhe urdhrit Nr. 100, datë 25.02.2022, "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar zhvillojnë procedurat për organizimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit janë të gjithë ata kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Profili ku kandidati do të kryejë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit lidhet me programin e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë që ka përfunduar kandidati.

Për vitin shkollor 2023-2024, aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit do të kryhet nëpërmjet platformës e-albania.

Kandidatët kanë të drejtë të zhvillojnë praktikën profesionale në një nga tri periudhat mësimore.

Afati i regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet platformës e-albania që do të zhvillojnë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit:

- në periudhën e parë mësimore është nga data 28.08.2023-07.09.2023
- në periudhën e dytë mësimore është nga data 04.12.2023-15.12.2023
- në periudhën e tretë mësimore është nga data 05.03.2024-15.03.2024

Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, 7 ditë pas mbylljes së aplikimit të secilës periudhë, dërgojnë në format excel, të dërguar nga DRAP-et përkatëse, listën e praktikantëve të periudhës përkatëse sipas tabelës bashkëlidhur shkresës.

Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, 7 ditë pas marrjes së listave nga ZVAP-të nën juridiksionin e tyre, hartojnë listat përfundimtare me kandidatët aplikantë të periudhës përkatëse në format excel dhe i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar 7 ditë pas marrjes së listave nga DRAP, dërgon listat përfundimtare të kandidatëve të periudhës përkatëse, zyrtarisht me postë dhe në rrugë elektronike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar publikojnë në faqet zyrtare të internetit, listën e IAPP-ve, publike dhe/ose private, që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale, në të tri fazat e aplikimit.

Praktikanti paraqitet në IAPP për të filluar praktikën profesionale në periudhën që ka aplikuar pas pranimit dhe lajmërimit nga ZVAP.

ZVAP-të janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur si dhe për respektimin me rigorozitet të kërkesave dhe të afateve të përcaktuara si më sipër.

Procesi i organizimit dhe zhvillimit të praktikës profesionale është objekt monitorimi nga MAS-ja, DPAP-ja dhe DRAP-et.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

